

eppc kërkon një Specialist Auditi për klientin e saj i cili është një ndër kompanitë më të mëdha në vend. Klienti ushtron prej 20 vitesh aktivitetin e tij duke u fokusuar në krijimin e vlerave ekonomike dhe shoqërore, në Shqipëri.

### MUNDËSIA JUAJ

Klienti është në kërkim të Specialistit të Auditit i cili duhet të performojë profesionalisht në pozicionin e Kontrollit të Brendshëm, nëpërmjet mbulimit të funksioneve të kontrollit operacional, financiar dhe përputhshmërisë me procedurat dhe rregulloret e departamentit dhe të shoqërive të Grupit.

Specialisti i Auditit do të kryej edhe detyrën e këshillimit/udhëzimit për menaxhimin e shoqërive të grupit, në lidhje me rregullat dhe procedurat. Ai/Ajo duhet të ruaj dhe respektoj, të gjitha standardet etike dhe profesionale gjatë kryerjes së detyrave të kontrollit.

### Përgjegjësitë Kryesore:

- Identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të ndryshme të shoqërive të grupit;
- Kryerjen e procedurave të auditimit;
- Identifikimin, zhvillimin, dhe dokumentin e proceseve të auditimit;
- Raportimin e rezultateve të auditimit dhe projekteve nëpërmjet raporteve të përcaktuara;
- Përfaqësimi i Departamentit të Auditit të Brendshëm në takime të ndryshme pune.

### Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare;
- Përvojë mbi 2 vjet në fushën e Auditimit të Brendshëm/Jashtëm;
- Përvojë në auditimin e operacioneve, kontabilitetit, analizave të biznesit dhe të programeve;
- Certifikimin profesional si audit IT, ose në kontabilitet, përbëjnë avantazh;
- Certifikim si Auditor i Brendshëm (CIA), përbën avantazh.

### Të dhënat

Pozicioni:	Specialist Auditi;
Vendndodhja:	Tiranë;
Orari:	40 orë në javë;
Raporton tek:	Drejtori i Departamentit të Auditimit;
Udhëtime pune:	Po, kryesisht brenda vendit;
Pagesa:	Ndër më të mirat në treg;
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	15 Maj 2013.

### Si të aplikoni

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke *përmendur pozicionin për të cilin aplikoni* në adresën e e-mail<sup>it</sup>: [recruitments@eppc.al](mailto:recruitments@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.

Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.